



Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo  
Institucioni i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmana • Ombudsperson Institution

*Ex officio*

Rasti Nr. 265/2017

## RAPORT ME REKOMANDIME

### I AVOKATIT TË POPULLIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

në lidhje me

*Faturimin e energjisë elektrike të shpenzuar në katër komunat veriore të  
Republikës së Kosovës*

**Drejtuar:**

- **Z. Arsim Janova, u.d. Kryesues i Bordit të Zyrës së Rregullatorit për Energji**
- **Z. Luan Morina, Udhëheqës i Departamentit të Energjisë, Ministria e Zhvillimit Ekonomik**
- **Z. Nijazi Shala, Udhëheqës i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorit, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë**

Prishtinë, më 13 qershor 2017

## PËRMBAJTJA

<b>QËLLIMET E RAPORTIT .....</b>	<b>3</b>
<b>BAZA LIGJORE .....</b>	<b>3</b>
<b>PËRMBLEDHJA E FAKTEVE.....</b>	<b>4</b>
<b>ARGUMENTI .....</b>	<b>6</b>
<b>A. Ligjshmëria .....</b>	<b>6</b>
<b>B. E drejta për të mos u diskriminuar .....</b>	<b>9</b>
<b>C. E drejta e pronës .....</b>	<b>14</b>
<b>D. Të drejtat e konsumatorit.....</b>	<b>15</b>
<b>KONSTATIMET DHE REKOMANDIMET E AVOKATIT TË POPULLIT.....</b>	<b>16</b>
<b>A. Konstatimet e Avokatit të Popullit .....</b>	<b>16</b>
<b>B. Rekomandimet e Avokatit të Popullit .....</b>	<b>17</b>

## QËLLIMET E RAPORTIT

1. Energjia elektrike e shpenzuar në katër komunat veriore të Republikës së Kosovës, përkatësisht Leposaviq, Mitrovica Veriore, Zubin Potok dhe Zveçan, faturohet tek konsumatorët e pjesës tjetër të Republikës, në shumën prej 8 milionë eurosh në vit. Zyra e Rregullatorit të Energjisë (në tekstin e mëtejshëm: “ZRRE”) dhe Departamenti i Energjisë i Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik (në tekstin e mëtejshëm: “Departamenti i Energjisë”), në komunikime ndërinstitucionale me Avokatin e Popullit, kanë pretenduar se kjo praktikë e faturimit është në përputhje me ligjet në fuqi për rregullimin e fushës së energjisë, në veçanti, me Ligjin Nr. 05/L-084 për Rregullatorin e Energjisë dhe Ligjin Nr. 05/L-085 për Energjinë Elektrike.

Ky Raport ka tri qëllime kryesore:

- (1) Për të vlerësuar nëse kjo praktikë e faturimit është vërtet në përputhje me legjislacionin e cituar nga ZRRE dhe Departamenti i Energjisë;
- (2) Për të vlerësuar nëse kjo praktikë e faturimit paraqet shkelje të të drejtave të njeriut, përkatësisht të së drejtës së pronës, së drejtës për të mos u diskriminuar dhe të drejtave të konsumatorit; dhe
- (3) Për t’u dhënë institucioneve kompetente rekomandime specifike dhe konkrete lidhur me veprimet që duhet të ndërmarrin për respektimin e plotë të ligjeve në fuqi dhe të të drejtave të njeriut.

## BAZA LIGJORE

2. Sipas Ligjit Nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, Avokati i Popullit, mes të tjerash, ka këto kompetenca dhe përgjegjësi:
  - “të hetojë shkeljet e pohuara të të drejtave të njeriut dhe veprimet e diskriminimit dhe të angazhohet për eliminimin e tyre (neni 18, par. 1, nënpar. 1);
  - “të tërheqë vëmendjen për rastet kur autoritetet i shkelin të drejtat e njeriut dhe të bëjë rekomandim që t’u jepet fund rasteve të tilla dhe kur është e domosdoshme të shprehë mendimin e vet mbi qëndrimet dhe reagimet e autoriteteve përkatëse në lidhje me rastet e tilla (neni 18, par. 1, nënpar. 2);
  - “të njoftojë Qeverinë, Kuvendin dhe institucionet tjera kompetente të Republikës së Kosovës për çështjet që kanë të bëjnë me avancimin dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, barazisë dhe jo diskriminimit” (neni 18, par. 1, nënpar. 5);
  - “t’i publikojë njoftimet, mendimet, rekomandimet, propozimet dhe raportet e veta” (neni 18, par. 1, nënpar. 6);
  - “të përgatisë raporte vjetore, periodike dhe të tjera mbi gjendjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, barazisë dhe diskriminimit dhe të kryejë hulumtime mbi çështjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, barazisë dhe diskriminimit në Republikën e Kosovës” (neni 18, par. 1, nënpar. 8);
3. Me dërgimin e këtij raporti tek institucionet kompetente, si dhe publikimin e tij në media, Avokati i Popullit synon të kryejë këto përgjegjësi ligjore.

## PËRMBLEDHJA E FAKTEVE

4. Avokati i Popullit, në bazë të nenit 16.4, të Ligjit për Avokatin e Popullit, nr. 05/L-019, më 7 prill 2017, ka iniciuar hetime me iniciativën e vet (*ex officio*) duke u bazuar në shkrimin e gazetës “Zëri”, të datës 7 prill 2017, me titull: “*KEDS-i na faturon 8 milionë euro në vit për rrymën e serbëve të veriut.*”
5. Më 28 prill 2017, Avokati i Popullit i ka drejtuar një letër Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRRE) me të cilën ka kërkuar informata si në vijim:
  - (1) Nëse vlera e energjisë që shpenzohet në veri të Kosovës është 8 milionë euro në vit dhe se kjo vlerë u shpërndahet nëpër fatura të qytetarëve në të gjithë Kosovën, ashtu siç është raportuar në shkrimin e gazetës “Zëri”;
  - (2) Cilat janë dispozitat ligjore që përcaktojnë se çfarë janë “humbjet e arsyeshme të cilat janë jashtë ndikimit të operatorit” dhe nëse këto dispozita lejojnë faturimin e energjisë elektrike pjesës tjetër të konsumatorëve, që janë konsumatorë të rregullt; dhe
  - (3) Nëse përveç ligjeve në fuqi, ekziston ndonjë vendim i ZRRE-së, Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik apo Qeverisë së Kosovës me të cilin rregullohet çështja e faturimit të rrymës në veri të Kosovës.
6. Më 18 maj 2017, Avokati i Popullit ka pranuar përgjigje nga ZRRE me ç’rast ZRRE është përgjigjur në pyetjet e Avokatit të Popullit si në vijim:
  - (1) ZRRE ka njoftuar se sipas operatorëve të licencuar energjia e pa faturuar në vitin 2016 në pjesën veriore të Kosovës 252 GWh, që përbën rreth 5.24% të kërkesës së shpërndarjes dhe se vlera e gjithmbarshme e energjisë së faturuar në veri të vendit është rreth 8 milionë euro. ZRRE ka shtuar se duke marrë parasysh se kjo vlerë është e pambuluar nga institucionet e Kosovës dhe duke mos pasur zgjidhje tjetër për të mbajtur sistemin elektroenergjetik në gjendje funksionale, ZRRE ka qenë e detyruar që kostot për mbulimin e humbjeve duke përfshirë edhe humbjet në veri t’i shpërndajë te të gjithë konsumatorët.
  - (2) Sa i përket pyetjes së dytë ZRRE i referohet nenit 48 [Miratimi i tarifave], paragrafi 3, pika 3.3, të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë Nr.05/L-084 dhe nenit 28 [Përgjegjësitë dhe të Drejtat e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes], paragrafi 1, pikat prej 1.21 deri 1.25 të Ligjit për Energjinë Elektrike Nr. 05/L-085. Sipas ZRRE neni 48, paragrafi 3, pika 3.3 përcakton se ZRRE gjatë miratimit apo caktimit të tarifave, do të sigurojë që të licencuarve t’iu mundësohet kthimi i të gjitha kostove të arsyeshme, duke përfshirë përveç tjerash edhe kostot e niveleve të humbjeve të energjisë në sistemet e transmetimit dhe të shpërndarjes. ZRRE më tej ka theksuar se furnizimi me energji elektrike i të gjithë konsumatorëve është obligim ligjor, prandaj gjatë miratimit të tarifave ZRRE merr në konsideratë një nivel të arsyeshëm të humbjeve, të cilat i trajton në mënyrë të barabartë në tërë territorin e Kosovës. ZRRE për më shumë ka theksuar se Operatori i Sistemit të

Shpërndarjes (OSSH) e ka të pamundur qasjen në veri të vendit dhe se humbjet që shkaktohen në veri të vendit nga OSSH konsiderohen si “humbje politike” që janë jashtë kontrollit të OSSH dhe se OSSH nuk mund të kryejë funksionet e veta për shkak të kostos së lartë të këtyre humbjeve, gjë që do të rrezikonte furnizimin e rregullt me energji elektrike në të gjithë vendin.

(3) Në pyetjen e tretë të Avokatit të Popullit ZRRE është përgjigjur se ka një vendim të datës 6 shkurt 2012, nr. V\_399\_2012 me të cilin përcaktohet niveli i reduktimit të humbjeve në shpërndarje. Sipas ZRRE ky vendim për reduktim të humbjeve përcakton nivelin e reduktimit të të gjitha humbjeve në sistemin elektroenergjetik duke përfshirë edhe humbjet në veri të Kosovës.

7. Avokati i Popullit më 22 maj 2017 ka zhvilluar një takim me përfaqësuesit e ZRRE-së për të mësuar rreth detajeve të përgjigjes nga ZRRE në veçanti rreth detajeve teknike lidhur me faturimin e rrymës së shpenzuar në veri. Përfaqësuesit e ZRRE-së kanë sqaruar se ekzistojnë dy lloj humbjesh të energjisë elektrike:

- Humbjet teknike që shkaktohen gjatë shpërndarjes së energjisë elektrike nëpër rrjetin e shpërndarjes dhe që janë humbje të rëndomta; dhe
- Humbjet komerciale që shkaktohen nga shfrytëzimi i paautorizuar i energjisë elektrike.

8. ZRRE ka sqaruar se rryma e shpenzuar në veri të Kosovës konsiderohet si humbje komerciale dhe se ka qenë e domosdoshme që këto humbje të mbulohen duke ia faturuar ato qytetarëve në mbarë territorin e Kosovës. Kjo sipas ZRRE ka qenë e domosdoshme për shkak se KEDS nuk do të mund t'i përballonte humbjet e energjisë dhe do t'i shkaktonte humbje të mëdha kompanisë, gjë që do të rrezikonte furnizimin e qytetarëve të Kosovës me energji elektrike.

9. Avokati i Popullit më 22 maj 2017 ka dërguar një letër Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë (MTI), Departamentit për Mbrojtje të Konsumatorit për të mësuar qëndrimin e ministrisë lidhur me shkeljet e mundshme të të drejtave të konsumatorëve me faturimin e rrymës së shpenzuar në veri qytetarëve në pjesë të tjera të Kosovës. Departamenti për Mbrojtje të Konsumatorëve i MTI më 29 maj 2017 ka dërguar përgjigje në kërkesën e Avokatit të Popullit në të cilën ka theksuar se Ligji për Mbrojtjen e Konsumatorit nuk rregullon fushat specifike të infrastrukturës së cilësisë së operatorëve publik, sikurse është rasti me energjinë elektrike.

10. Po ashtu, më 22 maj 2017, Avokati i Popullit ka dërguar një letër dhe Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik (MZHE), Departamentit të Energjisë, për të mësuar qëndrimin e kësaj ministrie lidhur me faturimin e rrymës së shpenzuar në veri qytetarëve në pjesë të tjera të Kosovës. Departamenti i Energjisë i MZHE më 29 maj 2017 ka dërguar përgjigje në kërkesën e Avokatit të Popullit, ku në mes tjerash ka pohuar se pamundësia e qasjes së Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (KEDS) dhe Kompanisë së Furnizim Publik (KESKO) lidhet me problemin e madh politik të integritetit të katër komunave të veriut të

Kosovës dhe se krijimi i kushteve për faturimin e energjisë elektrike në këtë pjesë të Kosovës ka qenë dhe vazhdon të jetë preokupim i Qeverisë së Kosovës. MZHE ka theksuar se furnizimi me energji për të gjithë konsumatorët është obligim ligjor dhe se ZRRE është organ i pavarur dhe se gjatë miratimit apo caktimit të tarifave, i siguron të licencuarat që t'iu mundësohet kthimi i të gjitha kostove të arsyeshme, duke përfshirë përveç tjerash edhe kostot e niveleve të arsyeshme të humbjeve të energjisë elektrike në sistemin e shpërndarjes dhe transmetimit.

## ARGUMENTI

### A. Ligjshmëria

11. Me qëllim të bazueshmërisë ligjore të faturimit të rrymës së shpenzuar në veri të Kosovës janë analizuar dispozitat ligjore të cilave u referohet ZRRE:

Ligji për Rregullatorin e Energjisë Nr.05/L-084

Neni 48 [Miratimi i tarifave], paragrafi 3, pika 3.3:

*3.Gjatë miratimit apo caktimit të tarifave, Rregullatori do të sigurojë që të licencuarve t'iu mundësohet kthimi i të gjitha kostove të arsyeshme, duke përfshirë:*

*3.3. kostot e niveleve të arsyeshme të humbjeve të energjisë në sistemet e transmetimit dhe shpërndarjes.*

Ligji për Energjinë Elektrike Nr. 05/L-085

12. Neni 28 [Përgjegjësitë dhe të Drejtat e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes], paragrafi 1, pikat prej 1.21 deri 1.25:

*1. Përgjegjësitë dhe të drejtat e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes janë:*

*1.21. sigurimi i energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes dhe për shërbimet ndihmëse në rrjetin e shpërndarjes, sipas parimeve të tregut të energjisë elektrike, transparencës dhe jodiskriminimit;*

*1.22. arritja e marrëveshjeve me shfrytëzuesit e rrjetit të shpërndarjes për ofrimin e shërbimeve ndihmëse për të realizuar, shërbimet ndihmëse në rrjetin e shpërndarjes në mënyrë ekonomike dhe efikase;*

*1.23. mirëmbajtja e regjistrit të pikave matëse për çdo palë përgjegjëse për jobalanc në pikat e livrimit në rrjetin e shpërndarjes;*

*1.24. analiza e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes në baza vjetore, duke përfshirë vlerësimin e humbjeve teknike dhe konsumin e paautorizuar të energjisë elektrike dhe, nëse është e nevojshme, zhvillimi dhe zbatimi i masave për reduktimin e humbjeve;*

*1.25. përgatitja brenda vitit aktual, e planit vjetor të humbjeve të shpërndarjes për vitin vijues dhe dorëzimi për miratim te Rregullatori. Plani vjetor i humbjeve përfshin vlerësimin e humbjeve teknike dhe konsumin e paautorizuar të energjisë elektrike;*

Vendimi i ZRRE V 399 2012, i datës 6 shkurt 2012

13. Vendimi ka të bëjë me reduktimin e humbjeve në shpërndarje i cili për qëllim ka reduktimin e humbjeve në shpërndarje për 3% në tri vitet e para dhe për 2.5% në tri vitet pasuese. Në arsyetimin e Vendimit thuhet se:  
*“Më datë 24 janar 2012, ZRRE ka pranuar një shkresë nga Këshilltarët e Qebrisë për Transaksionin e KEDS-it lidhur me vlerat indikativë të ZRRE-së. Në shkresën e tyre e cila sipas Këshilltarëve të Transaksionit, është hartuar më kërkesën e Ministrit për Zhvillim Ekonomik, ata theksojnë se vlerat indikativë të përcaktuara nga Rregullatori nuk janë të mjaftueshme për të siguruar investime në KEDS, në pajtim me strategjinë e Energjisë nga Kuvendi i Republikës së Kosovës.”*
14. Duke u bazuar në normat ligjore të sipërpërmendura Avokati i Popullit nuk mund të pajtohet me mënyrën se si rryma e shpenzuar në veri të Kosovës u faturohet qytetarëve në pjesë të tjera të vendit, për arsytet si më poshtë:
15. Ligji për Rregullatorin e Energjisë, neni 48, paragrafi 3, pika 3 përackton se *“...Rregullatori do të sigurojë që të licencuarve t’iu mundësohet kthimi i të gjitha kostove të arsyeshme, duke përfshirë:”...kostot e niveleve të arsyeshme të humbjeve të energjisë në sistemet e transmetimit dhe shpërndarjes.”*
16. Avokati i Popullit kishte ngritur pyetjen se çfarë janë “humbjet e arsyeshme” dhe kishte marrë përgjigje nga ZRRE, gjatë takimit më 22 maj 2017, se, sipas interpretimit të tyre zyrtar, humbjet e arsyeshme janë të dy llojeve: humbjet teknike që ndodhin në rrjetin e shpërndarjes dhe humbjet komerciale që përbëjnë shfrytëzimin e paautorizuar të energjisë elektrike (vjedhje të energjisë elektrike). Këto humbje të arsyeshme sipas ZRRE-së, do të duhej t’u ktheheshin operatorëve të licencuar.
17. Mirëpo, në përgjigjen me shkrim të ZRRE-së, humbjet e energjisë elektrike në pjesën veriore të Kosovës nga Operatori i Sistemit të Shpërndarjes konsiderohen si “humbje politike”. Praktikisht, me sa kuptohet, këto humbje që operatori i cilëson si humbje politike sipas interpretimit të ZRRE-së faturohen si humbje komerciale dhe barten nga qytetarët në pjesët tjera të Kosovës.
18. Siç është cituar më lart, Ligji për Energjinë Elektrike, neni 48, par. 3, pika 3 siguron kthimin e *“kostove të niveleve të arsyeshme të humbjeve të energjisë në sistemet e transmetimit dhe shpërndarjes”*. Rrjedhimisht, Avokati i Popullit konsideron se në rastin konkret bëhet fjalë për një praktikë që nuk është në pajtim me këtë dispozitë, përderisa kjo dispozitë mbulon humbjet e natyrës krejtësisht teknike, përkatësisht ato që ndërliken me parregullësi teknike në sistemin e transmetimit dhe shpërndarjes që, në asnjë mënyrë, nuk duhet të kalojë një “nivel të arsyeshëm”. Avokati i Popullit konsideron se 8 milionë euro humbje çdo vit nuk mund të cilësohet si humbje e nivelit të arsyeshëm siç e kërkon Ligji.

19. Ligji për Energjinë Elektrike, neni 28, par. 1, pika 25 përcakton se: *Përgjegjësitë dhe të drejtat e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes janë: . . . përgatitja brenda vitit aktual, e planit vjetor të humbjeve të shpërndarjes për vitin vijues dhe dorëzimi për miratim të Rregullatori. Plani vjetor i humbjeve përfshin vlerësimin e humbjeve teknike dhe konsumin e paautorizuar të energjisë elektrike.*
20. Energjia elektrike e shpenzuar në veri nuk mund të cilësohet si humbje komerciale ose konsum i paautorizuar, sepse Operatori i Sistemit të Shpërndarjes si dhe autoritetet përkatëse shtetërore janë në dijeni që nga periudha e pasluftës se qytetarët e pjesës veriore të Kosovës e shfrytëzojnë energjinë elektrike. Prandaj, shfrytëzimi i rrjetit të energjisë elektrike në veri të vendit është plotësisht i autorizuar.
21. Dispozitat e cekura nga vetë ZRRE të Ligjit për Energji Elektrike, neni 28, paragrafi 1, pika 21 përcakton se njëra ndër përgjegjësitë e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes është: *“sigurimi i energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes dhe për shërbimet ndihmëse në rrjetin e shpërndarjes, sipas parimeve të tregut të energjisë elektrike, transparencës dhe jodiskriminimit”.*
22. Ligji për Energjinë Elektrike me asnjë dispozitë të tij nuk i jep të drejtë Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes që shpenzimet e energjisë elektrike që shfrytëzohet në mënyrë të autorizuar me dijeninë e operatorit t’u faturohen qytetarëve që janë konsumatorë të rregullt, pa dijeninë e tyre. Prandaj, Avokati i Popullit konsideron se mënyra e tillë e faturimit të rrymës së shpenzuar në veri të Kosovës është diskriminuese dhe jotransparente dhe se është në kundërshtim me vet Ligjin për Energjinë Elektrike.
23. Përveç ligjeve të sipërpërmendura, Avokati i Popullit tërheq vëmendjen tek neni 23 i Rregullit për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji, i nxjerrë nga ZRRE në gusht të vitit 2011, i cili përcakton se:
- “Furnizuesi është i detyruar të sigurojë që konsumatorët të jenë të faturuar për energjinë e shfrytëzuar dhe për taksat e tjera, në përputhje me llojin e tarifës të dakorduar me Konsumatorin (nëse është e aplikueshme).”*
24. Meqenëse faturimi i rrymës së shpenzuar në veri nuk ka mbështetje në ligj, Avokati i Popullit ka analizuar edhe Vendimin e ZRRE V\_399\_2012, të datës 6 shkurt 2012 që sipas ZRRE përbën bazë për faturimin e rrymës në veri. Me sa mund të kuptohet vendimi ka të bëjë me rritjen e investimeve në KEDS për të evituar humbjet të cilat përcaktohen me ligj. Po ashtu, vërehet se Vendimi është nxjerrë më 6 shkurt 2012, ndërsa Operatori i Sistemit të Shpërndarjes (KEDS) dhe Kompania e Furnizimit Publik (KESKO) kanë marrë funksionet e shpërndarjes dhe furnizimit në maj të vitit 2013.<sup>1</sup> Vërehet se autoritetet përkatëse të Republikës së Kosovës paraprakisht kanë krijuar kushte të favorshme për KEDS dhe KESKO duke u garantuar investime për të mbuluar ato humbje që përcaktohen me ligj. Vendimi ZRRE V\_399\_2012, të datës 6 shkurt 2012 është akoma

<sup>1</sup> Informata e siguruar nga përgjigjia e Departamentit të Energjisë të MZHE dërguar Avokatit të Popullit më 29 maj 2017.



në fuqi. Arsyetimi i ZRRE se vlera prej 8 milionë euro është e papërballueshme për KEDS nuk është i qëndrueshëm. Lidhur me këtë arsyetim, Avokati i Popullit, gjatë takimit të zhvilluar me ZRRE-në më 22 maj 2017, ka pyetur për shumën e përfitimeve vjetore të KEDS-it. Përfaqësuesit e ZRRE-së nuk kishin informatë për këtë çështje. Në mungesë të këtij informacioni kyç, Avokati i Popullit refuzon ta marrë si të mirëqenë pretendimin se humbjet në fjalë janë të papërballueshme për KEDS-in. Nuk janë të qëndrueshme as pretendimet se shpenzimet e rrymës së shfrytëzuar në veri janë humbje të arsyeshme që duhet të mbulohen nga qytetarët në pjesë të tjera të territorit të Kosovës ndërsa të njëjtën kohë të arsyetohet se këto humbje kanë kosto të lartë për t'u përballuar nga Operatori i Sistemit të Shpërndarjes sepse nuk dihet më të vërtetë nëse këto janë humbje të nivelit të arsyeshëm apo janë humbje me kosto të papërballueshme. Kjo për shkak se dihet mirë se KEDS është një kompani fitimprurëse për të cilën nuk dihet se çfarë janë fitimet vjetore të saj.

25. Avokati i Popullit konsideron se pretendimet e ZRRE-së dhe Departamentit të Energjisë së MZHE-së se furnizimi me energji elektrike i qytetarëve është obligim ligjor duhet të jenë të qarta dhe te bazuara. Ligji për Energjinë Elektrike, neni 1, përcakton se qëllimi i ligjit është “. . . për të garantuar furnizim të sigurt . . . *me çmime reale* . . . ” (theks i shtuar). Edhe ku flitet për “shërbimin universal të furnizimit”, Ligji e ndërlidh këtë koncept me caktimin e “çmimit të arsyeshëm” (*po aty*, neni 3, par. 1, nënpar. 72). Këto dispozita lënë të kuptohet se garantimi i furnizimit të energjisë elektrike nuk është falas.

## **B. E drejta për të mos u diskriminuar**

26. E drejta për të mos u diskriminuar garantohet me Kushtetutë dhe me ligj. Kushtetuta përcakton se: “Askush nuk mund të diskriminohet në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimeve politike ose të tjera, prejardhjes kombëtare a shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, pronës, gjendjes ekonomike, sociale, orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar ose ndonjë statusi tjetër personal” (neni 24, par. 2).
27. Po ashtu, Ligji Nr. 05/L-021 për Mbrojtjen nga Diskriminimi, përcakton se: “Parimi i trajtimit të barabartë nënkupton se nuk do të ketë kurrfarë diskriminimi të drejtpërdrejtë apo të tërthortë sipas kuptimit të cilësdo nga bazat e përcaktuara në nenin një (1) të këtij Ligji” (neni 3, par. 1), ku në listën e këtyre “bazave të përcaktuara”, përfshihet si kategori e hapur “ose ndonjë bazë tjetër” (neni 1, par. 1).
28. Koncepti i “diskriminimit” që përdoret në Kushtetutë, është i njëjlojtë me atë të përdorur në Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Për interpretimin e konceptit kushtetues të diskriminimit, duhet marrë parasysh neni 53 i Kushtetutës, i cili udhëzon se “[t]ë drejtat e njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut” (në tekstin e mëtejshëm: “GJEDNJ”). Sipas vendimeve gjyqësore të GJENDJ-së, “[e] drejta . . . për të mos u diskriminuar . . . shkelet kur Shtetet trajtojnë në mënyrë jo të barabartë persona në situata të ngjashme pa dhënë një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm” (*Thlimmenos v.*

*Greece*, Aplikimi Nr. 34369/97, GJEDNJ, 6 prill 2000, par. 44). Në mënyrë që një justifikim i tillë të jetë “objektiv dhe i arsyeshëm”, ai duhet të plotësojë dy kushte të mëtejshme: (1) duhet të ketë një “qëllim legjitim” për pabarazinë në fjalë dhe (2) duhet të ketë një “lidhje të arsyeshme të proporcionalitetit midis mjetit të përdorur dhe qëllimit të synuar” (“*Relating to Certain Aspects of the Laës on the Use of Languages in Education in Belgium*” v. *Belgium*, Aplikimet Nr. 1474/62, 1677/62, 1691/62, 1769/63, 1994/63, 2126/64, GJEDNJ, 23 korrik 1968, par. 10; shih gjithashtu *Case of X and Others v. Austria*, Aplikimi Nr. 19010/07, GJEDNJ, 19 shkurt 2013, par. 98).

29. Po ashtu, Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi përcakton se: “Diskriminim është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë në çfarëdo baze të përcaktuara në nenin një (1) të këtij Ligji, që ka për qëllim apo efekt të zhvleftësojë ose cenojë njohjen, gëzimin ose ushtrimin, në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave dhe lirive themelore të njohura nga Kushtetuta dhe ligjet tjera të aplikueshme në Republikën e Kosovës” (neni 3, par. 2). Njësoj si vendimet gjyqësore të GJEDNJ-së, Ligji thekson se një trajtim jo i barabartë mund të justifikohet nëse ka “një qëllim legjitim dhe ekziston një marrëdhënie e arsyeshme proporcionaliteti ndërmjet mjeteve të përdorura dhe qëllimit të synuar” (po aty, neni 6).
30. Vlen të theksohet se edhe Ligji për Rregullatorin e Energjisë dhe Ligji për Energjinë Elektrike, thirren vazhdimisht në parimet e trajtimit të barabartë dhe mosdiskriminimit. Shih, p.sh., Ligjin për Rregullatorin e Energjisë, neni 15, par. 1, nënpar. 1.4 (Rregullatori e ka përgjegjësinë “të sigurojë që aktivitetet e energjisë të kryhen në mënyrë transparente dhe jodiskriminuese . . . , si dhe të sigurojë qasje jodiskriminuese në sistemet e transmetimit, të shpërndarjes dhe të interkoneksionit”); dhe Ligjin për Energjinë Elektrike, neni 5, par. 9 (“Rregullatori përcakton ndarjen e shpenzimeve të obligimeve të shërbimit publik të vendosura . . . tek konsumatorët fundorë në mënyrë jodiskriminuese dhe transparente”).
31. Duke përmbledhur kriteret e lartpërmendura mbi diskriminim, praktika e faturimit të energjisë elektrike të shpenzuar në veri të Republikës tek konsumatorët e tjerë, duhet të vlerësohet sipas disa hapave analitikë si në vijim:
- (1) A paraqet kjo praktikë e faturimit një trajtim jo të barabartë ndërmjet personave në situata të ngjashme, në bazë të një statusi personal të përcaktuar në Kushtetutë ose Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi?
  - (2) Nëse po, a ka një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm për këtë trajtim jo të barabartë?  
Ose, me fjalë të tjera:
    - (a) A ka kjo praktikë e faturimit një qëllim legjitim?
    - (b) Nëse po, a ka një lidhje të arsyeshme të proporcionalitetit ndërmjet këtij qëllimi dhe praktikës së faturimit në fjalë?

32. Tek hapi i parë i analizës, është e qartë se praktika e faturimit në fjalë përbën një trajtim jo të barabartë ndërmjet personave në situata të ngjashme. Përkatësisht, disa shfrytëzues të energjisë elektrike nuk paguajnë për sasinë energjisë që e shpenzojnë, ndërsa shfrytëzuesit e tjerë paguajnë jo vetëm për pjesën që e shpenzojnë ata vetë, por edhe për pjesën e shpenzuar nga ata që nuk paguajnë. Në këtë mënyrë, KEDS-i, me autorizimin e ZRRE, nuk trajton të gjithë shfrytëzuesit e rrjetit elektrik sipas të njëjtit standard.
33. Avokati i Popullit konsideron se me gjithë perceptimin e mundshëm të publikut se pabarazia bazohet mbi *përkatësinë etnike*, Avokati i Popullit konsideron se këtu kemi të bëjmë me një pabarazi jo në bazë të *përkatësisë etnike*, por në bazë të *vendbanimit*: Banorët në veri të Republikës nuk detyrohen të paguajnë për sasinë e energjisë që e harxhojnë, ndërsa banorët në pjesën tjetër të Republikës detyrohen të paguajnë për sasinë e energjisë që e harxhojnë vetë, si dhe për atë të harxhuar nga banorët në veri. Kjo nuk mund të cilësohet si një pabarazi mbi baza etnike, përderisa në veri të Republikës ka banorë që nuk janë të komunitetit serb dhe, po ashtu, në pjesën tjetër të Republikës ka banorë që nuk janë të komunitetit shqiptar.
34. Është e vërtetë se as në Kushtetutë, as në ligj, nuk njihet “vendbanimi” shprehimisht si bazë e mundshme diskriminimi. Megjithatë, kjo nuk do të thotë se praktika aktuale e faturimit s’mund të kualifikohet si diskriminim. Siç u vërejt më sipër, Kushtetuta dhe ligji përcaktojnë se diskriminimi mund të bazohet në “ndonjë status tjetër personal” (Kushtetuta, neni 24, par. 2) ose “ndonjë bazë tjetër” (Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi, neni 1, par. 1) që nuk ceket shprehimisht me Kushtetutë ose me ligj. Vendbanimi mund të konsiderohet si bazë e tillë, në përputhje të plotë me vendimet gjyqësore të GJEDNJ-së. *Shih, p.sh., Carson and Others v. The United Kingdom*, Aplikimi Nr. 42184/05, GJEDNJ, 16 mars 2010, § 70 (“fjalëve ‘status tjetër’ . . . u është dhënë kuptim i gjerë për të përfshirë . . . një dallim *në bazë të vendbanimit*”, theks i shtuar). Prandaj, edhe pse “vendbanimi” nuk përmendet shprehimisht në Kushtetutë ose në ligj si bazë e mundshme diskriminimi, detyrimi jo i barabartë për të paguar për energji elektrike, në bazë të vendbanimit, mund të konsiderohet prapëseprapë si praktikë diskriminuese, varësisht prej përfundimit të hapave të tjerë të analizës.
35. Tek hapi i dytë i analizës, duhet të pyesim nëse ka një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm për praktikën aktuale të faturimit. Siç u pa më sipër, në mënyrë që të ekzistojë një justifikim objektiv dhe i arsyeshëm për këtë praktikë, dy kriteret e mëtejshme duhet të përmbushen: (1) praktika e faturimit në fjalë duhet të ketë një qëllim legjitim dhe (2) duhet të ekzistojë një lidhje e arsyeshme e proporcionalitetit ndërmjet kësaj praktike dhe qëllimit të synuar.
36. Avokati i Popullit konsideron se praktika e faturimit në fjalë ka një qëllim legjitim. Sipas shprehjes së pranuar nga ZRRE, fakti se Operatori i Sistemit të Shpërndarjes (OSSH) nuk ka qasje në veri të Republikës, do të thotë se nuk ka mundësi të faturojë banorët në këtë pjesë të Republikës dhe, rrjedhimisht, duhet të gjejë një mundësi tjetër për t’u kompensuar për energjinë e shpenzuar në këtë rajon. Sipas ZRRE-së, “[n]ëse nuk

mbulohen këto humbje atëherë OSSH nuk mund të kryejë funksionet e veta për shkak të kostos së lartë të këtyre humbjeve, gjë që do të rrezikonte furnizimin e rregullt me energji elektrike të konsumatorëve në tërë Kosovën” (Shkresa e ZRRE-së, f. 3). Sipas këtij pretendimi, qëllimi i faturimit të konsumatorëve të tjerë për energjinë e shpenzuar në veri të Republikës, është që të mos rrezikohet furnizimi i tërë vendit me energji elektrike. Ky qëllim është, qartazi, një qëllim legjitim.

37. Megjithatë, Avokati i Popullit konsideron se praktika e faturimit në diskutim dështon tek kriteri i dytë: nuk ekziston një *lidhje e arsyeshme e proporcionalitetit* ndërmjet kësaj praktike të faturimit dhe qëllimit për t’i shmangur rrezikimin e sistemit të energjisë elektrike në mbarë vendin.
38. Për të vlerësuar *proporcionalitetin* e praktikës në diskutim, Avokati i Popullit vëren fillimisht se, sipas Gjykatës Kushtetuese, “testi i proporcionalitetit është përshkruar në nenin 55 të Kushtetutës” (Rasti Nr. KO131/12, Dr. Shaip Muja dhe 11 deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Aktgjykim, 15 prill 2013, par. 127). Avokati i Popullit konsideron se praktika e faturimit në diskutim bie në kundërshtim me dy kërkesa të nenit 55 dhe, për rrjedhojë, nuk mund të cilësohet si masë proporcionale.
39. Së pari, neni 55, par. 1 përcakton që: “Të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, *mund të kufizohen vetëm me ligj*” (theks i shtuar). Kemi vërejtur gjithashtu në Pjesën A se praktika aktuale e faturimit nuk është në përputhje me Ligjin për Rregullatorin e Energjisë dhe Ligjin për Energjinë Elektrike. Kjo do të thotë se trajtimi jo i barabartë i banorëve të veriut kundrejt banorëve të pjesës tjetër të Republikës, nuk është i autorizuar me ligj dhe, prandaj, është masë joproportionale sipas nenit 55, par. 1.
40. Së dyti, neni 55, par. 4 i Kushtetutës përcakton se: “Me rastin e kufizimit të të drejtave të njeriut dhe interpretimit të atyre kufizimeve, të gjitha institucionet e pushtetit publik. . . e kanë për detyrë t’i kushtojnë kujdes . . . raportit midis kufizimit dhe qëllimit që synohet të arrihet, *si dhe të shqyrtojnë mundësinë e realizimit të atij qëllimi me kufizim më të vogël*” (theks i shtuar). Në rastin konkret, kjo dispozitë kërkon që ZRRE-ja, si dhe të gjitha institucionet kompetente për rregullimin ligjor të fushës së energjisë elektrike, të shqyrtojnë nëse qëllimi i pretenduar i praktikës aktuale të faturimit (d.m.th., qëllimi i mos rrezikimit të sistemit të energjisë elektrike në mbarë Republikën) mund të arrihet me një trajtim të barabartë ndërmjet të gjithë banorëve të vendit.
41. Siç është argumentuar sipër në Pjesën A, ka arsye për të dyshuar pretendimin që humbja e 8 milionë eurove do të ishte e papërballueshme për KEDS-in. Mirëpo, edhe nëse e marrim si të mirëqenë, për hir të argumentit, se e ka të pamundur të mbulojë vetë një humbje të tillë, Avokati i Popullit vëren se nuk ka asnjë dëshmi që këto institucione kanë shqyrtuar ashtu siç duhet çështjen nëse humbjet në veri të Republikës do të mund të shmangeshin në ndonjë mënyrë alternative, pa i detyruar banorët në pjesën tjetër të vendit që të paguajnë për energjinë elektrike që të tjerët e kanë shpenzuar.

42. Në veçanti, Avokati i Popullit konsideron se një mënyrë për t'iu shmangur humbjeve në fjalë, do të ishte që ZRRE-ja ose Qeveria të njoftonte katër komunat e veriut se, në përputhje me normat kushtetuese dhe ligjore kundër diskriminimit, mundësimi i qasjes për KEDS-in, me qëllim të matjes dhe faturimit të energjisë së shpenzuar, është kusht i domosdoshëm i furnizimit me energji elektrike në këto katër komuna, ashtu siç është në të gjithë Republikën e Kosovës. Avokati i Popullit nuk ka asnjë dëshmi që KEDS-i, Qeveria apo ZRRE-ja, ka *shqyrtuar* se cilët hapa do të duhej të ndërmerreshin për t'i mundësuar qasje KEDS-it, as më pak që ka ndërmarrë pozitivisht ndonjë hap të tillë. Një zgjidhje e tillë do të siguronte që qëllimi i pretenduar i ZRRE-së (që të shmangen humbjet në veri të vendit në mënyrë që të mos rrezikohet funksionimi i tërë sistemit), të arrihet duke trajtuar të gjithë banorët e Kosovës në mënyrë të barabartë. Përderisa ekziston të paktën kjo mundësi alternative për të arritur qëllimin e shmangies së humbjeve në veri të Republikës, dhe përderisa kjo alternativë e arrin qëllimin e pretenduar me një kufizim më të vogël të së drejtës për të mos u diskriminuar, atëherë praktika aktuale e faturimit del që të jetë masë joproportionale në kundërshtim me nenin 55, par. 4 të Kushtetutës. Me fjalë të tjera, praktika në fjalë dështon tek hapi i fundit i analizës dhe, për këtë arsye, paraqet shkelje të së drejtës për të mos u diskriminuar. Dy kundër argumenteve të mundshme duhet t'u japim përgjigje.
43. Së pari, mund të argumentohet se ZRRE-ja e ka për detyrë të sigurojë energji elektrike për banorët e veriut të Republikës, edhe nëse këta të fundit nuk paguajnë për shërbimin e ofruar. Në këtë drejtim, shkresa e ZRRE-së pretendon se “furnizimi me energji elektrike i të gjithë konsumatorëve është obligim ligjor, prandaj ZRRE konform obligimeve kërkon nga operatorët e licencuar që të furnizojnë me energji elektrike të gjithë konsumatorët. Andaj, gjatë miratimit të tarifave ZRRE merr në konsideratë një nivel të arsyeshëm të humbjeve, e të cilat i trajton në mënyrë të barabartë në tërë territorin e Kosovës” (Shkresa e ZRRE-së, f. 3). Po ashtu, Departamenti i Energjisë pretendon se: “Bazuar në legjislacionin për energjinë, furnizimi me energji për të gjithë konsumatorët është obligim ligjor”. Mirëpo, Avokati i Popullit vëren se ZRRE nuk citon asnjë dispozitë ligjore në mbështetje të pretendimit të tij se furnizimi i të gjithë banorëve të vendit me energji elektrike, është obligim ligjor *edhe për ata banorë që nuk paguajnë për energjinë që e konsumojnë*. Një obligim i tillë nuk ekziston, përveçse në raste të veçanta të parashikuara me ligj, si p.sh. konsumatorët në nevojë, megjithëse ligji përcakton se edhe kjo kategori “nuk duhet të financohet nga konsumatorët e energjisë elektrike” (Ligji për Energji Elektrike, neni 49, par. 2, nënpar. 2.4). Përveç rasteve të tilla specifike, obligimi ligjor për furnizimin e konsumatorëve me energji elektrike, siç është argumentuar në Pjesën A, gjithmonë bazohet në ofrimin e një çmimi të arsyeshëm për këtë shërbim. Kjo nënkupton se energjia elektrike nuk vjen pa pagesë për ata që e konsumojnë. Avokati i Popullit kërkon vetëm që ky parim të zbatohet për të gjithë banorët e Republikës në mënyrë të barabartë, si për banorët e veriut, ashtu edhe për banorët e pjesës tjetër të vendit.
44. Së dyti, mund të argumentohet se ZRRE-ja është e pafuqishme për të kërkuar qasje për KEDS-in në veri të Republikës, përderisa kjo çështje rregullohet me një marrëveshje të veçantë që është në pritje të zbatimit. Në shkresën e pranuar prej Departamentit të

Energjisë të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, pretendohet se: “Qeveria e Kosovës, problemën e mos faturimit të energjisë elektrike në katër komunitet e veriut të Kosovës e ka adresuar në Marrëveshjen e Brukselit për Energjinë”, në të cilën “kërkohet nga palët nënshkruese që të themelohet një kompani e re për furnizim me energji elektrike sipas kornizës ligjore dhe rregullatore të Kosovës”. Mirëpo, “zbatimi i kësaj marrëveshjeje është duke hasur në vështirësi për shkak të obstrukcioneve të Serbisë”.

45. Me gjithë këtë vështirësi, Avokati i Popullit konsideron se moszbatimi aktual i marrëveshjes nuk paraqet asnjë pengesë që ZRRE-ja të kërkojë, të paktën deri sa të zbatohet marrëveshja, që katër komunitet përkatëse t’ia mundësojnë KEDS-it faturimin e energjisë së shpenzuar nga banorët e tyre, në mënyrë që ata të paguajnë vetë, për sasinë e energjisë që vetë e kanë shpenzuar. Për atë kohë që KEDS-i po i furnizon këto komunitet me energji elektrike, ato e kanë për detyrë t’i sigurojë qasje për qëllimet e matjes dhe faturimit të sasisë së energjisë së shpenzuar. Një zgjidhje e tillë, jo vetëm se nuk e pengon zbatimin e marrëveshjes në të ardhmen, por gjithashtu u jep palëve nënshkruese një shtytse edhe më të fortë për t’i zbatuar dispozitat e kësaj marrëveshjeje sa më shpejt që të jetë e mundur.

### C. E drejta e pronës

46. Neni 46, par. 1 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: “Kushtetuta”) përcakton se: “E drejta e pronës është e garantuar”. Mirëpo, kjo nuk do të thotë se eksproprijimi i pronës është i ndaluar në mënyrë kategorike. Përkundrazi, Kushtetuta pohon shprehimisht që “Republika e Kosovës ose autoriteti publik i Republikës së Kosovës mund të bëjë eksproprijimin e pronës” (*po aty*, neni 46, par. 3). Megjithatë, autorizimi kushtetues i eksproprijimit nuk është pa kufi. Në veçanti, eksproprijimi mund të kryhet vetëm nëse “është i autorizuar me ligj” (*po aty*, neni 46, par. 3, theks i shtuar).
47. Kërkesa që eksproprijimi të kryhet vetëm në përputhje me ligj, gjen mbështetje të mëtejshme nga dy burime të tjera kushtetuese. Së pari, neni 1 i Protokollit të Parë i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: “KEDNJ”) përcakton se: “Askush nuk mund të privohet nga posedimet e tij, përveçse . . . **në kushtet e parashikuara nga ligji**” (theks i shtuar). E drejta e përcaktuar me këtë dispozitë, njësoj si të gjitha të drejtat e përcaktuara në KEDNJ dhe Protokollin e saj, “garantohe[t] me këtë Kushtetutë” (Kushtetuta, neni 22). Në të njëjtën mënyrë, kemi vërejtur se neni 55, par. 1, i Kushtetutës përcakton se: “Të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, mund të kufizohen vetëm me ligj” (theks i shtuar).
48. Për interpretimin e këtyre dispozitave, u referohemi përsëri vendimeve gjyqësore të GJEDNJ-së, ashtu siç kërkohet nga neni 53 i Kushtetutës. Sipas vendimeve gjyqësore të GJEDNJ-së, koncepteve të “pronës” dhe të “posedimit” u është dhënë një kuptim i gjerë, duke përfshirë çdo lloj pronësie të luajtshme dhe të paluajtshme, si dhe një sërë interesash ekonomike. Në veçanti, GJEDNJ ka konstatuar se: “Tatimi është, parimisht, një kufizim i

së drejtës së garantuar me paragrafin e parë të nenit 1 të Protokollit të Parë [të KEDNJ-së], për shkak se ai [tatimi] e privon personin në fjalë nga një posedim, d.m.th., *nga sasia e parave që duhet paguar*” (*Burden v. United Kingdom*, Aplikimi Nr. 13378/05, GJEDNJ, 29 prill 2008, § 59, theks i shtuar). Sipas këtij arsyetimi, çdo herë që shteti e detyron një individë për të paguar një sasi parash, kjo konsiderohet një kufizim i së drejtës së pronës.

49. Rrjedhimisht, kur KEDS-i, duke vepruar me autorizimin e ZRRE-së, i detyron konsumatorët e tjerë për të paguar për sasinë e energjisë elektrike të shpenzuar nga banorët e veriut të Republikës, kjo konsiderohet si kufizim i së drejtës së pronës, për shkak se konsumatorët e faturuar privohen “nga një posedim, d.m.th., nga sasia e parave që duhet paguar”.

50. Kemi vërejtur se është kërkesë e Kushtetutës që çdo kufizim i së drejtës së pronës të jetë i autorizuar me ligj. Prandaj, praktika e faturimit në diskutim, si kufizim i së drejtës së pronës, duhet të jetë i autorizuar me ligj. Mirëpo, në Pjesën A më sipër, është argumentuar se kjo praktikë e faturimit nuk është në përputhje me Ligjin për Rregullatorin e Energjisë dhe Ligjin për Energjinë Elektrike. Për rrjedhojë, faturimi i sasisë së energjisë elektrike të shpenzuar në veri të vendit tek konsumatorët e pjesës tjetër të vendit, nuk plotëson kërkesat kushtetuese dhe, për këtë arsye, përbën shkelje të së drejtës së pronës.

51. Përveç së drejtës kushtetuese të pronës, Avokati i Popullit ka analizuar dispozitat e Ligjit Nr. 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve, duke marrë parasysh se faturimi i energjisë elektrike krijon marrëdhënie juridiko-civile që bie në fushëveprimin e këtij ligji. Në këtë kontekst, Avokati i Popullit vëren se Ligji përcakton si në vijim: “*Secili person që pasurohet pa bazë ligjore në dëm të një tjetrit, është i detyruar të kthejë atë që ka marrë nga tjetri, ose ndryshe të kompensojë vlerën e fitimit të arritur*”, ku “[f]jala pasurim po ashtu përfshin përvetësimin e fitimit përmes shërbimeve” (neni 194, par. 1 dhe 2). Në bazë të këtyre dispozitave, konsumatorëve të cilët, pa dijeninë e tyre, kanë paguar për energjinë e shpenzuar në veri të Republikës, u lind e drejta për kthimin e shumës që janë detyruar ta paguanin.

#### **D. Të drejtat e konsumatorit**

52. Të drejtat e konsumatorit rregullohen me Ligjin për Mbrojtjen e Konsumatorit nr. 04 / L - 121. Me këtë ligj garantohen të drejtat themelore të konsumatorit siç janë e drejta për të mbrojtur interesat ekonomike të konsumatorit si dhe e drejta për të mbrojtur pronën (neni 4). Në bazë të këtij ligji janë përcaktuar detyrimet e shitësit i cili është i detyruar që për shërbimin e ofruar konsumatorit t’i japë faturë të saktë si dhe të drejtën e konsumatorit për të kontrolluar sasinë e faturuar në lidhje me shërbimin e ofruar (neni 12). Sipas të këtij ligji faturimi i energjisë llogaritet në bazë të konsumit real të lexuar në njehsorin e konsumatorit. Lidhur me këtë furnizuesi duhet të paraqesë në faturë shënimet që i mundësojnë konsumatorit kontrollin e sasisë dhe vlerës për konsumin e energjisë e po

ashtu faturimi i energjisë të llogaritet në bazë të konsumit real i cili vlerësohet nëpërmjet njësoveve të kalibruar (neni 29).

53. Po ashtu, vetë Ligji për Energjinë Elektrike, neni 48, par. 4, pika 3, përcakton se “Konsumatori ka të drejtë të . . . pranojë informata transparente për çmimet dhe tarifat e vlefshme dhe kushtet e afatet standarde, në lidhje me qasjen dhe përdorimin e shërbimeve të energjisë elektrike”.
54. Me këtë rast Avokati i Popullit dëshiron të tërheqë vëmendjen e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorit pranë Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, i cili ka pohuar, me përgjigjen e datës 29 maj 2017, drejtuar Avokatit të Popullit, se Ligji për Mbrojtjen e Konsumatorit “në këtë rast nuk rregullon fushat specifike të infrastrukturës së cilësisë dhe operatorëve publik, sikurse e kemi rastin konkret në relacion me energjinë elektrike”. Këtë pretendim e hedh poshtë vetë Ligji për Energjinë Elektrike, i cili përcakton se: “Konsumatori fundor gëzon mbrojtjen e të drejtave të tij në pajtim me . . . legjislacionin që rregullon mbrojtjen e konsumatorit” (neni 48, par. 1).
55. Rrjedhimisht, Avokati i Popullit konstaton se në rastin konkret janë cenuar dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konsumatorit dhe vetë Ligjit për Energjinë Elektrike. Më saktësisht është cenuar interesi ekonomik dhe prona e qytetarëve të Republikës së Kosovës dhe e drejta e konsumatorit për të pasur faturë të saktë si dhe mundësinë për të kontrolluar sasinë e faturuar për shërbimin e ofruar. Gjithashtu është cenuar e drejta e konsumatorit për të pasur faturim të energjisë në bazë të konsumit real që është lexuar në njehsorin e konsumatorit si dhe të ketë në faturë shënimet në bazë të të cilave i mundësohet konsumatorit kontrolli i sasisë dhe vlerës për konsumin e energjisë.

## **KONSTATIMET DHE REKOMANDIMET E AVOKATIT TË POPULLIT**

### **A. Konstatimet e Avokatit të Popullit**

56. Në bazë të vlerësimit të mësipërm, Avokati i Popullit konstaton se:

- (1) Faturimi i energjisë elektrike të shpenzuar në katër komunat veriore të Republikës së Kosovës tek konsumatorët e tjerë në pjesën tjetër të vendit, paraqet shkelje të Ligjit Nr. 05/L-084 për Rregullatorin e Energjisë dhe Ligjit Nr. 05/L-085 për Energjinë Elektrike.
- (2) Kjo praktikë e faturimit paraqet shkelje të së drejtës së pronës, të garantuar me nenin 46 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenin 1 të Protokollit 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, si dhe sjell deri tek pasurimi i pabazë sipas nenit 194 të Ligjit Nr. 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve.
- (3) Kjo praktikë e faturimit paraqet shkelje të së drejtës për të mos u diskriminuar, të garantuar me nenin 24 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe Ligjin Nr. 05/L-021 për Mbrojtjen nga Diskriminimi.



(4) Kjo praktikë e faturimit paraqet shkelje të të drejtave të konsumatorit, të garantuara me Ligjin Nr. 04/L-121 për Mbrojtjen e Konsumatorit.


## **B. Rekomandimet e Avokatit të Popullit**

Në bazë të këtyre konstatimeve, dhe në përputhje me nenin 135, par. 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenin 16, par. 4 të Ligjit Nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, Avokati i Popullit rekomandon që:

- (1) ZRRE urgjentisht të ndalë praktikën e kundërligjshme të faturimit të energjisë elektrike të shpenzuar në veri të Republikës së Kosovës tek konsumatorët në pjesën tjetër të vendit;
- (2) Qeveria e Republikës së Kosovës, në bashkëpunim me ZRRE-në dhe KEDS-in, të gjejë një mënyrë alternative për t'iu shmangur humbjeve në veri të vendit, duke trajtuar të gjithë konsumatorët në mënyrë të barabartë sipas normave kushtetuese dhe ligjore kundër diskriminimit;
- (3) ZRRE-ja, në pajtim me Ligjin Nr. 05/L-084 për Rregullatorin e Energjisë, të nxjerrë një vendim, me anë të të cilit do të miratohej zbritja e tarifave deri në atë masë që do të mundësonte kompensimin e konsumatorëve të cilët, padrejtësisht, janë faturuar, dhe vazhdojnë të faturohen, për energjinë elektrike të shpenzuar në katër komunitet veriore.

Në pajtim me nenin 132, paragrafi 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (“Çdo organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar t’u përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t’i paraqesë atij/asaj të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara në pajtim me ligj”) dhe nenin 28 të Ligjit Nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit (“Autoritetet, të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar rekomandim, kërkesë ose propozim për ndërmarrjen e veprimeve konkrete, . . . duhet të përgjigjen brenda afatit tridhjetë (30) ditor. Përgjigjja duhet të përmbajë arsyet me shkrim për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë”), mirësisht Ju lutemi të na informoni për veprimet që do të ndërmerreni lidhur me këtë çështje.

Me nderime,



Hilmi Jashari

Avokat i Popullit